



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-136

Prishtinë, më 2 dhjetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 2 DHJETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Myfera Shinik dhe Goran Marinković.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të Kryesisë, të mbajtur më 25 nëntor 2013,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 25 nëntor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25 nëntor 2013.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës:

Kryesia, pas shqyrtimit të përgatitjeve të nevojshme për seancën plenare të radhës, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, konfirmoi se mbledhja plenare e radhës do të mbahet të enjten, më 5 dhjetor 2013, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës magjistrale Milloshevi-Mitrovicë, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID),*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 03/L-102,*
7. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për lojërat e fatit,*
8. *Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 dhe*
9. *Emërimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.*

Kryesia pasi diskutoi për pikën 8 të rendit të ditës së lartshënuar, gjithashtu, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 radhitet për shqyrtim në seancë plenare më 5 dhjetor 2013.
2. Ftohet Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi, ta paraqesë raportin vjetor për vitin 2013, para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

- 1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Radiotelevizionit të Kosovës për transferimin e mjeteve për RTK-në, sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës*

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit të Kosovës që të bëjë transferimin e mjeteve financiare në vlerë prej 1 000 000 euro (një milion euro), në pajtim me procedurat për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Kuvendit, kategoria ekonomike-subvencione dhe transferimet në xhirollogarinë e Radiotelevizionit të Kosovës, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 11/152 dt. 18.10.2013.

- 2. Kërkesa e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për procedimin e raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012, si dhe njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me procedimin e raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartcekur, vendosi që të pritet deri në përgatitjen e raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, pastaj të procedohet raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012.

- 3. Kërkesa e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, z. Zenun Pajaziti, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kuvendi nuk e merr përsipër mbulimin e shpenzimeve për realizimin e vizitës të kryetarit të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, z. Zenun Pajaziti, për të marrë pjesë në Lutjen Evropiane të Mëngjesit, e cila do të organizohet në Bruksel të Belgjikës, më 3-4 dhjetor 2013.
2. Udhëtimi mund të realizohet me shpenzime të Grupit Parlamentar.

4. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për pjesëmarrjen në Konferencën e mbajtur në Mal të Zi, prej datës 17-19 nëntor 2013

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për pjesëmarrje në Konferencën e mbajtur në Mal të Zi, prej 17-19 nëntor 2013.

Pika shtesë:

1. Sqarimi shtesë i Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia, pasi diskutoi për çështjen e lartcekur, këtë pikë të rendit të ditës e radhiti për mbledhjen plenare të radhës që Kuvendi të deklarohet rreth propozimit të Qeverisë për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale